

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM

*Medvin Shehu, Sofika Note, Anjeza Gazidede dhe Erjona Suljoti
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë*

KORRIK 2022

*Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk
pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

P Ë R M B A J T J E

<i>Hyrje</i>	4
<i>Përmbledhje</i>	5
<i>1. Kredia për biznese</i>	6
<i>2. Kredia për individë</i>	11
<i>3. Tendencat e kreditimit në vendet e rajonit</i>	15

HYRJE

Ky material synon të japë një panoramë të prirjes së aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, në të analizohen të dhënat monetare, si dhe kushtet e kreditimit, bazuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues. Pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në disa nga vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuara në material janë: a) të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin privat të ekonomisë; b) të dhënat cilësore të marra nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues (VAK); c) statistikat për normat e interesit të kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro; d) të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgaria (BU), Kroacia (CR), Rumania (Ro), Serbia (Sr), Polonia (Pl), Hungaria (Hu), Republika Çeke (CZ), Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV).

Të dhënat e kredisë merren nga bilanci të bankave dhe i referohen financimit të bankave vendase për sektorin privat rezident - bizneseve dhe individëve. Ndryshe nga më parë, analiza e portofolit të kredisë bazohet në setin e ri të informacionit të përgatitur nga Departamenti i Statistikave Financiare në linjë me metodologjinë e BQE-së për flukset "reale" të kredisë - të pastruar si nga lëvizjet e kursit të këmbimit, ashtu edhe nga kreditë e nxjerra nga bilanci. Si pasojë e ndryshimeve metodologjike, vlerat aktuale janë më të larta se normat e rritjes së analizuar deri më sot. Pavarësisht ndryshimeve, të dyja seritë tregojnë ecuri të njëjtë në kohë të kreditimit.

Materiali mbulon të dhënat e disponueshme deri më 22 korrik 2022, të cilat përfshijnë të dhënat monetare dhe financiare në vend, deri në muajin qershor 2022, dhe të dhënat e Vrojtimin të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e dytë të vitit 2022. Të dhënat e kredisë për vendet e rajonit janë deri në muajin maj 2022.

PËRMBLEDHJE


Zhvillimet në portofolin e kredisë për sektorin privat në tremujorin e dytë të vitit 2022, tregojnë se:

- **Kredia për biznese** ka shfaqur ritme më të larta rritjeje. Ky përmirësim ka reflektuar më së shumti rritjen e kredisë në lekë për bizneset me madhësi mesatare. Paralelisht, kreditimi në valutë ka vijuar me norma të larta rritjeje, i mbështetur nga kreditimi i biznesit të madh. Ndërkohë, bankat kanë filluar të reflektojnë një kujdes të shtuar, i cili vihet re si në drejtim të shtrëngimit të ofertës për kredi ashtu edhe në rritjen e normave të interesit në disa segmente.
- **Kredia për individë** ka shfaqur përmirësim të ritmeve të rritjes, duke reflektuar lehtësimin e standardeve të kreditimit edhe rritjen e kërkesës, veçanërisht për kredi hipotekare. Kjo kërkesë është shoqëruar edhe me rritjen e kreditimit në valutë të individëve, krahas financimit në lekë, i cili ka ruajtur norma të larta rritjeje.
- **Normat e interesit për kreditë e reja në lekë** kanë regjistruar një rënie të lehtë për bizneset në tremujorin e dytë të vitit, ndërkohë që janë rritur për individët. Analiza e interesave sipas kategorive tregon se rritja e normës bazë po fillon të reflektohet fillimisht në kreditë që janë më të standardizuara siç janë kreditë e vogla për biznese dhe kreditë për individët. Në tërësi, rritjet e interesave janë ende minimale dhe niveli i tyre mbetet akomodues për rritjen e mëtejshme të kredisë.
- Bankat kanë vijuar **shtrëngimin e kushteve të kreditimit për biznese**, ndërsa i kanë **lehtësuar ato për individët** duke ruajtur të njëjtën përqasje si në tremujorin e parë. Përqasja më e kujdesshme e bankave ndaj biznesit lidhet si me pasigurinë e shtuar ashtu edhe me tolerancën më të ulët të tyre ndaj rrezikut. Ndërsa, lehtësimi i standardeve për individët është mbështetur tek konkurrenca e lartë dhe ecuria e tregut të banesave.
- **Në vendet e rajonit**, kredia për sektorin privat është rritur me ritme të larta. Rritja e saj është përshpejtuar në shumicën e vendeve, ku vendet e Ballkanit kanë shënuar në vazhdimësi një performancë më të mirë krahasuar me vendet e Evropës Qendrore. Rritja e kreditimit është mbështetur nga kredia për biznese, ndërkohë që kredia për individë shfaqet e ngadalësuar në pjesën më të mirë të vendeve.


1. KREDIA PËR BIZNESE

Kredia për biznese ka shfaqur përmirësim të ritmeve të rritjes në tremujorin e dytë. Zgjerimi i portofolit të kredisë për bizneset e mesme dhe të mëdha ka kompensuar tkurrjen e portofolit të biznesit të vogël. Këto zhvillime janë reflektuar në norma më të larta të rritjes së kredisë në lekë dhe ruajtjen e niveleve të larta të kreditimit në valutë. Megjithatë, shtimi i pasigurive dhe shqetësimet mbi dobësimin e mundshëm të aktivitetit ekonomik me zgjatjen e konfliktit në Ukrainë, kanë diktuar shtrëngimin e standardeve të kreditimit nga bankat për bizneset, si dhe shtrenjtimin e kostos së kredisë në segmente të caktuara.

Financimi i bizneseve nga bankat është rritur me ritme të larta në tremujorin e dytë të vitit. Norma vjetore e rritjes së këtij portofoli prej 12%, ka ndjekur trajektoren pozitive të nisur një vit më parë me rikthimin e normalitetit ekonomik pas pandemisë. Dinamika tremujore tregon se ky portofol është rritur me rreth 11 miliardë lekë. Zgjerimi i kredisë për biznese është vërejtur në segmentin e biznesit të mesëm dhe të atij të madh, ndërkohë që ka rënë financimi për bizneset e vogla dhe është ngadalësuar për ato mikro. Të dy këto segmente janë edhe kategoritë më të ekspozuara ndaj pasigurisë dhe rrezikut të shtuar në kushtet e realitetit të ri makroekonomik. Kështu, kredia për biznesin e mesëm shënoi një rritje vjetore rreth dy herë më shumë se në tremujorin e parë. Ndërkohë, kreditimi i biznesit të madh ka mbajtur norma të qëndrueshme rritjeje, por në ndryshim nga biznesi i mesëm kjo rritje ka qenë kryesisht në valutë.




Dekompozimi në terma të monedhës tregon se kreditimi në lekë i bizneseve ka shfaqur përmirësim të ritmeve të rritjes në 6.7% ose 1.3 pp më shumë se në tremujorin e parë. Financimi i nevojave të biznesit të mesëm në lekë, ka qenë segmenti që ka kontribuar më shumë në këtë ecuri. Ky segment ka kompensuar në të njëjtën kohë edhe tkurrjen e kredisë në lekë për biznesin e vogël. Nga ana tjetër, rritja e kredisë në segmentin mikro ishte e gjitha në lekë në këtë tremujor. Paralelisht, kreditimi në valutë ka vijuar tendencën pozitive, ku norma e rritjes vjetore prej 16% ishte 0.3 pp më shumë se në tremujorin e parë. Zhvillimet e tremujorit të dytë tregojnë për një zgjerim të kreditimit në dollarin amerikan, i cili ka kompensuar disi dhe ngadalësimin e kredisë në euro. Në fund të gjashtëmujorit të parë, kredia në lekë për bizneset zinte 42.9% të totalit, rreth 0.7 pp më pak se në vitin 2021.



Normat e interesit për kreditë për biznese kanë shënuar rënie në tremujorin e dytë të vitit, si për kreditë në lekë, ashtu edhe për ato në euro. Në terma mesatarë, ato u janë afruar niveleve të vitit të kaluar për të dyja monedhat. Ulja e interesit tek kreditë në lekë reflekton reduktimin e interesave tek kreditë e mesme dhe të mëdha duke "korrigjuar" pjesërisht rritjen e tyre një tremujor më parë. Nga ana tjetër, interesi i kredive të vogla në lekë ka shënuar rritje gjatë këtij tremujori.

Norma mesatare e interesit për kreditë për biznese në tremujorin e dytë rezultoi 5.5% nga 5.8% që ishte një tremujor më parë, duke u luhatur pranë mesatares së saj për vitin 2021. Reduktimi i interesave këtë tremujor ka ardhur nga rënia e normave për kreditë mbi 35 mln lekë. Interesi mesatar për këto kredi shënoi 5.3%, nga 5.9% që ishte në tremujorin e parë, duke iu rikthyer vlerës mesatare të vitit të kaluar. Norma e interesit për kreditë e vogla (deri në 35 mln lekë), nga ana tjetër, është rritur në 6.2%, nga mesatarja prej 6.0% e tremujorit të mëparshëm dhe e vitit 2021.

Interesi për këtë kategori, e cila përkon kryesisht me financimin e biznesit të vogël e të mesëm, ka qenë përgjithësisht më i lartë se interesi për kreditë më të mëdha gjatë vitit 2021 dhe në vitin aktual, me mesatarisht 0.5 pikë përqindje. Kjo është edhe kategoria ku rritja e normës bazë po fillon të transmetohet më shpejt, duke qenë se kushtet për kreditë e vogla janë më të standardizuara. Gjithashtu, për kreditë e mëdha, fuqia negociuese e bizneseve është më e madhe, çka mund të sjellë edhe terma më të lehtësuara kreditimi në krahasim me kreditë e vogla. Kjo konfirmohet edhe nga analiza sipas fiksimit fillestar të interesit, e cila evidenton se interesat e kredisë me normë fillestare interesi të pandryshuar deri në një vit janë ulur krahasuar me tremujorin e parë dhe me vitin e kaluar.



Normat e interesit për kreditë në euro të bizneseve kanë shënuar rënie gjatë tremujorit të dytë të vitit. Ato rezultuan mesatarisht 4.3% në këtë tremujor, nga 4.9% në tremujorin e parë të vitit dhe 4.5% mesatare e vitit 2021. Ndryshe nga kredia në lekë, interesi i kredisë në euro këtë tremujor ka reflektuar uljen e tyre për të gjitha kategoritë, por më e theksuar tek kreditë mbi 250 mijë euro. Interesat e kredisë deri në këtë shumë kanë regjistruar rënie të lehtë prej mëse një viti.


Kushtet joçmim janë shtrënguar për bizneset, në reflektim të një përqsasjeje më të kujdesshme të bankave ndaj financimit të bizneseve, si pasojë e perceptimit për rrezik të shtuar në këtë segment.

Tabloja e kushteve në kreditimin e bizneseve nuk ndryshoi nga ajo e një tremujori më parë. Bankat tregtare vijuan të jenë prudenë në miratimin e kredive të reja për bizneset në tërësi, me theks më të lartë tek kreditë për investime. Ambianti ekonomik me paqartësi të shtuara, si pasojë e luhatjes së lartë të çmimeve në tregjet ndërkombëtare nga konflikti i armatosur Rusi – Ukrainë, perceptohet si rrezik i lartë nga ana e bankave, duke shtuar nga

ana tjetër edhe shqetësimet mbi aftësinë paguese të firmave në vend. Në këtë kontekst, bankat shtrënguan jo vetëm kushtet e termat e kreditimit, por edhe standardet – në një linjë me pritjet e një tremujori më parë – në kreditë e reja akorduar bizneseve. Paralelisht, bankat u treguan edhe më të kujdesshme këtë tremujor, duke miratuar një numër më të ulët aplikimesh në raport me totalin e aplikimeve për kredi nga ana e bizneseve.

Bankat raportuan marzhe më të larta këtë tremujor, ku rritja më e theksuar ishte mbi marzhet e kredive me rrezik. Njëherazi, bankat i shtrënguan kushtet e termat e kreditimit joçmim formues, nëpërmjet miratimit të kredive në madhësi më të ulëta nga ajo e kërkuar prej bizneseve, si dhe duke shtuar numrin e kushtëzimeve në marrëveshjet e nënshkruara mes palëve. Ofrimi i mundësisë për zgjatjen e maturitetit maksimal të kredisë, ishte i vetmi instrument që ndikoi bizneset në kahun lehtësues të kushteve e termave të kreditimit.

Grafik 4. Kushtet joçmim për kreditë e reja të bizneseve.




Për informacion më të detajuar lutemi referojuni rubrikës mbi vrojtimin e aktivitetit kreditues në linkun:
https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/.

Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të stafit.

2. KREDIA PËR INDIVIDË


Kredia për individë është rritur me ritme më të larta në tremujorin e dytë. Përshpejtimi i normave të rritjes është mbështetur nga kreditimi në valutë. Ndjekja e politikave lehtësuese për kreditimin e individëve si për konsum ashtu edhe për kredi hipotekare ka akomoduar kërkesën e lartë për financim të individëve në banka. Megjithatë, ecuria e normave të interesit sinjalizon për rritjen e kostove të kredisë për individë.

Financimi i individëve nga bankat ka vijuar me ritme të larta edhe në tremujorin e dytë të vitit. Norma vjetore e rritjes së kredisë për këtë segment arriti në 17% ose 0.7 pp më shumë se në tremujorin e parë. Zgjerimi tremujor prej 12 miliardë lekësh ishte ndër më të lartët historikë, duke u mbështetur si nga kredia në lekë ashtu edhe nga ajo në valutë. Këtë tremujor, rritja e kredisë në lekë për individët ishte rreth 2 herë më e lartë se në tremujorin e parë, duke formuar 60% të zgjerimit të kredisë për këtë segment. Norma vjetore e kësaj kategorie prej 16.7% qëndroi në nivelet e larta të tremujorit të parë. Paralelisht, me rritje të lartë vijoi edhe kredia në valutë për individë. Norma vjetore prej 21.7% shënoi një tjetër rritje nga nivelet e larta të tremujorit të parë.



Zhvillimet sipas qëllimit të përdorimit të kredisë nxjerrin në pah se kredia për banesa është segmenti kryesor që mbështet normat e larta të rritjes. Zgjerimi i këtij portofoli karakterizohet si nga kërkesa e lartë e individëve për të marrë financim - e diktuar nga çmimet e larta të blerjes së apartamenteve - ashtu edhe nga politikat e bankave për të ofruar kushte lehtësuese veçanërisht për këtë segment. Prej një viti vihet re se tendenca e zhvendosjes së këtij portofoli drejt lekut ka ndaluar, ndërkohë që diferenca e normave të interesit për këtë segment ka filluar të zgjerohet së fundmi. Kredia konsumatore vijon të

dominohet nga kreditimi në lekë. Në tremujorin e dytë të vitit 2022, vihet re që rritja e këtij segmenti është ndjeshëm më e lartë se në tremujorin e parë, e lidhur kjo dhe me sezonalitetin që e karakterizon këtë segment.




Normat e interesit për kreditë në lekë të individëve kanë filluar të tejçojnë rritjen e normës bazë të interesit. Rritja e tyre në tremujorin e dytë të vitit ka reflektuar kryesisht rritjen e interesit për kreditë hipotekare, ndërsa për kreditë konsumatore rritja ka qenë më e përmbajtur. Kredia hipotekare në euro ka vijuar të lëvrohet me interesa të ulëta.

Normat e interesit për kreditë për individë kanë shënuar rritje në tremujorin e dytë të vitit. Rritja më e spikatur në këtë tremujor ishte tek kreditë hipotekare, ku interesi i tyre rezultoi 4.0% nga 3.6% që ishte në tremujorin e mëparshëm dhe 3.7% në vitin 2021. Në një krahasim të shtrirë në kohë, interesi aktual është gjithsesi më i ulët se niveli 4.4% për periudhën 2018-2020. Dy vitet e fundit janë karakterizuar nga një kërkesë e lartë e individëve për kredi hipotekare, e cila është akomoduar nga bankat me kushte të lehtësuara kreditimi. Diferenca e interesit për këto kredi kundrejt yield-it të bonove të thesarit 12-mujore, që shpesh përdoret si normë referencë, ka qëndruar e ulët në gjysmën e parë të këtij viti, në 1.9%, dhe pothuaj aq sa ishte edhe gjatë vitit 2021. Për periudhën 2018-2020, kjo diferencë ishte mesatarisht 2.4 pikë përqindje.

Duke pasur parasysh nivelin e lartë të standardizimit tek kreditë hipotekare dhe të vogla¹, rritja e interesave në këtë tremujor duket të reflektojë rritjen e normës bazë në fund të tremujorit të parë të vitit. Analiza sipas periudhës së fiksimit të normës së interesit evidenton rritje të interesave tek të gjitha maturitetet, me rreth 0.3-0.4 pikë përqindje.


¹ Kreditë hipotekare edhe ato të vogla deri në shumën 35 mln lekë për nga numri janë edhe kreditë më të shumta.

Grafik 7. Ecuria e normave të interesit për kreditë në lekë për individët



Tremujori i dytë i këtij viti ka shënuar një rritje edhe në interesin e kredisë konsumatore. Ky interes rezultoi me një nivel mesatar prej 9.3%, nga 9.1% në tremujorin e parë të vitit. Rritja e interesit për këtë lloj kredie ishte më e përmbajtur në këtë tremujor, pas rritjes që shfaqti në tremujorin e parë të vitit. Normat e interesit për kreditë konsumatore janë luhatur rreth nivelit 8.1% për periudhën 2018-2021.

Grafik 8. Ecuria e normave të interesit për kreditë hipotekare në euro për individët




Norma mesatare e kredive hipotekare në euro për individë shënoi një rënie të lehtë në tremujorin e dytë të vitit. Ajo rezultoi 3.4%, nga 3.6% që ishte në tremujorin e parë të vitit, duke qëndruar pranë mesatares së vitit të kaluar. Këto nivele janë ndër më të ulëtat për kredinë hipotekare në euro. Sipas periudhës së fiksimit të normës së interesit, reduktimi i lehtë i normave këtë tremujor është diktuar nga ulja e normës së interesit për kreditë me normë interesi fikse për më

shumë se 1 vit, ndërkohë që ajo me normë të ndryshueshme për vitin e parë është rritur. Diferenca midis interesit të kredisë hipotekare në lekë dhe asaj në euro është rritur gjatë këtij tremujori, por ajo mbetet gjithsesi në nivelet më të ulëta të saj.

Kushtet dhe termat e kreditimit për kreditë e reja akorduar individëve vijuan lehtësimin

Politikat e kreditimit për individët, ndryshe nga ato për bizneset, ishin më lehtësuese, si në kreditë konsumatore, ashtu edhe ato hipotekare. Krahas lehtësimit të standardeve, bankat aplikuan kushte dhe terma kreditimi më favorizuese për individët. Konkurrenca e shtuar në sistemin bankar si dhe objektivat e disa prej bankave për të zotëruar një fraksion të caktuar të portofolit të kredisë në sistem— si hipotekare, ashtu edhe konsumatore – kanë diktuar qasjen lehtësuese kundrejt individëve në tremujorin e dytë.


Elementet joçmim nëpërmjet të cilave u lehtësuan kushtet e kreditimit ishin zgjatja e maturitetit maksimal të kredisë në kreditë hipotekare dhe miratimi i shumave më të larta për kreditë konsumatore. Ndërkohë, elementet çmim në kreditë e individëve ishin më të shtrënguara në sajë të marzheve më të larta të aplikuar mbi kreditë e konsideruara me rrezik.



3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT²


Kredia për sektorin privat në vendet e rajonit është rritur me ritme të larta gjatë muajve prill dhe maj. Rritja vjetore e saj është përshpejtuar në shumicën e vendeve, ku vendet e Ballkanit kanë shënuar në vazhdimësi një performancë më të mirë krahasuar me vendet e Evropës Qendrore. Rritja e kreditimit është mbështetur nga kredia për biznese, ndërkohë që kredia për individë shfaqet e ngadalësuar që prej fillimit të këtij viti. Në muajt në vazhdim, pritet një kërkesë për kredi e orientuar kryesisht drejt likuiditetit për bizneset dhe drejt kredisë hipotekare për individët, ndërkohë që kushtet e kreditimit pritët të shtrëngohen, në reflektim të pasigurive të shtuara dhe perspektivës më të dobët ekonomike.

Kredia për sektorin privat është rritur me ritme të larta në të gjitha vendet e rajonit në gjysmën e parë të vitit. Pavarësisht perspektivës më të dobët ekonomike, çmimeve të larta, rritjes së normave të interesit dhe shtimit të pasigurive që solli lufta Rusi-Ukrainë, këto ritme janë mbartur edhe në muajt prill dhe maj. Rritja vjetore e saj regjistroi mesatarisht 7.9% në këta dy muaj, nga 8.1% që ishte në tremujorin e parë të vitit. Në terma gjeografikë, ajo ka ruajtur nivele të larta në të gjitha vendet, por vendet e Ballkanit vazhdojnë të performojnë më mirë krahasuar me vendet e Evropës Qendrore. Në terma të klientit, kredia për individë ka dhënë shenja ngadalësimi, ndërkohë që kredia për biznese është përshpejtuar, një tendencë kjo e pranishme që në fillim të këtij viti.



² Në këtë analizë përfshihen 9 vende të rajonit të Evropës Qendrore dhe Juglindore: Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kroaci, Serbi, Bullgari, Ruman, Çeki, Poloni dhe Hungari. Stoku i kredisë për sektorin privat është i rregulluar për efektin e kursit të këmbimit. Nisur nga luhatjet e mëdha të normave të inflacionit në muajt e fundit, në këtë analizë, stoku i kredisë nuk është deflatuar me inflacionin, pasi mund të paraqesë mesazhe të shformuara për ecurinë e kredisë në afat të shkurtër.

Gjatë vitit 2021, me rimëkëmbjen e ekonomive pas krizës së induktuar nga pandemia, u regjistrua një rritje e kërkesës për kredi në vendet e rajonit. Kjo e fundit ishte me bazë të gjerë, për likuiditet, investime e konsum. Në të njëjtën kohë, edhe bankat lehtësuan standardet e kreditimit. Deri në fillim të këtij viti, pritshmëritë ishin që tendenca të mbarteshin edhe gjatë vitit 2022.³ Realiteti i ri e ka ndryshuar këtë tablo. Për tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit, bankat janë shprehur se do të shtrëngojnë kushtet e kreditimit për të gjitha llojet e kredive, por kryesisht për ato afatgjata dhe për kreditë e bizneseve.




Kredia për biznese në rajon ka vijuar të shfaqë ecuri të mirë në muajt prill dhe maj 2022. Rritja vjetore e saj shënoi mesatarisht 11.1% në këta muaj, nga 8.7% që ishte në tremujorin e parë të vitit. Ajo është më e larta në dhjetë vitet e fundit, pas ngadalësimit të zgjatur në kohë që pësoi kreditimi në rajon pas krizës greke. Ecuria e kredisë për biznese është e mirë në të gjitha vendet, por Rumania dallon për ritmet veçanërisht të larta të rritjes që prej vitit të kaluar.

Rritje më të përshpejtuar në pjesën e parë të këtij viti shfaqin Kroacia, Maqedonia e Veriut dhe Bullgaria, ndërkohë që në Shqipëri dhe në Serbi rritja është e qëndrueshme. Tendenca rritëse është e pranishme edhe në vendet e Evropës Qendrore, ku në Hungari ka vijuar të ketë ritme të larta e të qëndrueshme, ndërkohë që Çekia dhe Polonia kanë shënuar rritje të ndjeshme pas ngadalësimit apo edhe tkurrjes në vitin 2021. Kërkesa e bizneseve për kredi në rajon deri në tremujorin e tretë të vitit pritet të jetë e orientuar drejt mbulimit të nevojave për likuiditet dhe drejt ristrukturimit të borxheve ekzistuese.

³ Sikurse raportohet në VAK-un për vendet e EQJL-së. Për më shumë detaje, mund t'i referoheni adresës së mëposhtme: <https://www.eib.org/en/publications/cesee-bls-2022-h1>

Grafik 12. Kredia për individë në rajonin e EQJL-së



Kredia për individë paraqet shenja ngadalësimi në muajt prill dhe maj në një pjesë të mirë të vendeve. Rritja vjetore e saj shënoi 6.0% në këta dy muaj, nga 7.7% në tremujorin e parë të vitit. Zhvillimet në këtë segment paraqiten më pak homogjene mes vendeve. Në Shqipëri, Bullgari dhe Rumani, kredia për individë është zgjeruar ndjeshëm krahasuar me vitin e kaluar. Ndërkohë, në pjesën më të madhe të vendeve të tjera, ajo është rritur me ritme më të ngadalta, e veçanërisht në Poloni. Hendeku mes vendeve të Ballkanit dhe atyre të Evropës Qendrore sa i takon rritjes së kredisë për individë është zgjeruar ndjeshëm në dy muajt e fundit. Pasiguritë e shtuara për të ardhmen kanë diktuar kufizimin e kredive konsumatore dhe orientimin e kërkesës së individëve për financim vetëm drejt kredive hipotekare.